

# Mbajini bateritë në formë kopse larg nga fëmija

Nëse fëmija juaj gëlltit një bateri në formë kopse, ajo mund t'i bllokohet në grykë. Mund të shkaktojë djegie në artierien kryesore dhe t'i shkaktojë dëmtime të rënda, e madje vdekje. Kjo mund të ndodhë shumë shpejt.

Fëmijët e moshës 6 muaj deri në 4 ½ vjeç janë më të rrezikuar.



## Cilat bateri janë më të rrezikshmet

Bateritë në formë kopse me celula litiumi janë paksa më të mëdha se një monedhë 5 cent. Atë janë aq të mëdha sa të bllokohen dhe janë aq të forta sa të vrasin.

Bateritë e vogla në formë kopse mund të shkaktojnë dëmtime, sidomos nëse janë të reja.

## Ku janë?

Fëmija juaj mund të gjejë bateri në formë kopse në gjëra të tilla si:

- ✎ telekomandat e vogla
- ✎ çelësat e makinave ose aparatet për gjetjen e çelësave
- ✎ kartolinat dhe librat muzikorë
- ✎ lodrat me ndriçim dhe sendet e reja
- ✎ dritat e natës
- ✎ peshoret digjitale
- ✎ termometrat
- ✎ lodrat e vjetra në kutinë e lodrave

Fëmijët mund të gjejnë gjithashtu bateri rezervë që mbahen në një vend ku ata mund t'i marrin ose që kanë rënë nga paketimi.

Edhe bateritë e përdorura që janë shkarkuar plotësisht kanë përsëri karikim të mjaftueshëm sa që të jenë të rrezikshme.

## Kontrolloni shtëpinë

- ✎ Kërkoni në shtëpi nëse keni bateri në formë kopse
- ✎ Mbajini produktet larg fëmijëve nëse vendi ku ndodhet bateria e tyre nuk është i siguruar mirë
- ✎ Mbajini larg edhe bateritë rezervë dhe bateritë që janë shkarkuar plotësisht
- ✎ Bëni kujdes nga ofertat në dyqanet online ose në dyqanet pranë me zbritje. Ata mund të shesin bateri, të cilat fëmija juaj mund t'i marrë me lehtësi

## A ka gëlltitur fëmija juaj një bateri të tillë?

- ✎ **Mos vono. Çojeni menjëherë në A&E ose telefononi 999 për një ambulancë.**
- ✎ Tregojini mjekut nëse mendoni se fëmija juaj ka gëlltitur një bateri në formë kopse.
- ✎ Nëse e keni paketimin e baterisë ose produktin të cilit i përkiste bateria, merreni me vetë.
- ✎ Mos i lini të hanë ose të pinë dhe mos i detyroni që të vjellin

**Mund të ketë disa simptoma. Prandaj besojuni instinkteve tuaja.**

 [capt.org.uk/button-batteries](https://www.capt.org.uk/button-batteries)

 @ChildAccidentPreventionTrust

  
child accident  
prevention trust